



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA Nr. 03-227

8.8.2022

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/ 14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) të të njëjtit ligj, pika 6 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015 dhe Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore nr.10-2856/1 datë 19.7.2022, dhe Konkluzion me nr.ark.02-3032/6 datë 8.8.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 30-të mbajtur më 8.8.2022, miratoi sa vijon:

Aktvendim për marrjen e masës-paralajmërim publik

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK Shtip, për shkak të shkeljes së nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në mënyrë që shërbimi programor televiziv i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK Shtip, më 5 korrik 2022, nuk ka transmetuar të paktën 30% program të prodhuar burimisht si vepra audiovizuale maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar (përcaktuar) në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, nr. 10-2856/1 datë 19.7.2022, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi me Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK Shtip që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, është kompetente për të kryer mbikëqyrje (monitorim) programor të transmetuesve dhe ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspektin e respektimit të dispozitave të ligjit të cituar, lejeve, certifikatave të regjistrimit të lëshuara, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ndërmer masë - për paralajmërim publik

në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur bëhet shkelje e dispozitave të Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe aktet tjera të Agjencisë.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizive, përmes Sektorit për çështje programore, më 19 korrik 2022, ka kryer mbikëqyrje (monitorim) të rregullt programor të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV- STAR SHPK Shtip, i transmetuar më 5 korrik 2022, në nivel rajonal, në të cilën u konstatua shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele Përkatësisht, më 5 korrik 2022, servisi (shërbimi) programor televiziv i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK Shtip,

1

ka transmetuar 5 orë 57 minuta dhe 28 sekonda program të prodhuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është 26,82% e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës, i cili është përfshirë në llogaritjen për programin e prodhuar burimor (22 orë 12 minuta e 57 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% transmetimesh të një programi të prodhuar burimor në një ditë, në raport me transmetimin total të programit më 5 korrik që përfshihet në llogaritjen e programit të prodhuar burimor (22:12:57), është 6 orë 39 minuta dhe 53 sekonda. Televizioni STAR ka transmetuar për 42 minuta dhe 25 sekonda më pak program të prodhuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij Vendimi është përcaktuar (specifikuar) në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, nr. 10-2856/1, datë 19.7.2022, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtesë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ka dërguar tek SHTR TV-STAR SHPK Shtip, më 21.7.2022, Shkresë me nr.ark.10-2856/1 datë 19.7.2022 , me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.10-2856/1 datë 19.7.2022, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë sqarim me shkrim lidhur me shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV.Në afatin e paraparë, gjegjësisht më 25.7.2022, SHTR TV-STAR SHPK Shtip i ka dorëzuar Agjencisë një deklaratë me shkrim me nr.ark..10-2856/3 datë 25.7.2022. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 8.8.2022, shqyrtoi Raportin me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim me nr.ark.10-2856/3 datë 25.7.2022. dhe konkludoi se ndaj SHTR TV-STAR SHPK Shtip, t'i shqiptohet masa-paralajmërim publik.

Si pasojë e sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, si dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) të të njëjtit ligj, pika 6 nga Udhëzuesi për caktimin e afatit për veprim sipas Vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) nr. 10-2856/1, datë 19.7.2022, dhe Raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me nr. 10-2856/1 datë 19.7.2022, për shkak të konstatimit për mos respektimit të dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në e seancën e 30-të mbajtur më 8.8.2022, në pajtim me Konkluzionin Nr. 02-3032/6 të datës 8.8.2022, ka marrë Vendim me të cilin publikisht paralajmërohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK dhe urdhërohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh. nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, veprimi sipas Vendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ky Vendim është përfundimtar, ndërkaq kundër tij, transmetuesi mund të ngrejë padi për kontest administrativ në gjykatën kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ ngrihet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngriejë padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ ngrihet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e realizuar programore, nr.10-2856/1 nga 19.7.2022.

Dorëzuar tek:

- Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK Shtip;
- Udhëheqësit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-STAR SHPK Shtip,
- Personit përgjegjës të programit në SHTR TV-STAR SHPK Shtip;
- Sektorit për Çështje juridike dhe furnizim publik;
- Sektorit për Çështje programore; dhe
- Personi i emëruar në Agjenci për udhëheqjen e regjistrit Pa1..